


KUVENDI I KOMUNËS
KAÇANIK
-Shërbimi i Kuvendit-



MUNICIPALITY
ASSEMBLY OF
KACANIK

BULETINI
PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS
26.10.2002-31.12.2006

KAÇANIK
Janar,2007

Hyrje

Ky Buletin përfshinë aktivitetin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut në mandatin e dytë të zgjedhjeve.

Buletini përmban aktivitetin që ka zhvilluar Kuvendi i Komunës prej zgjedhjeve vendore të datës 26.10.2002 e deri me 31.12.2006. Pjesë përbërse e këtij Buletini do të jet edhe periudha: 01.01.2007 deri me zgjedhjet e ardhëshme vendore, respektivisht deri më përfundimin e mandatit të këtij kuvendi.

Bazë për përpilimin e këtij Buletini kanë shërbyer Procesverbalet e përpiluara gjat punës së Kuvendit.

Qëllimi i këtij Buletini është pasqyrimi i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës në periudhën e dytë mandatore, sistemimi i tyre dhe njoftimi i strukturave komunale në drejtim që të jet sa më transparent aktiviteti i zhvilluar.

Buletini është përpiluar nga shërbimi për punë profesionale të kuvendit dhe ky shërbim është mirënjohës për të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet të cilat do të i ipen lidhur me të. Këto vërejtje dhe sugjerime do të ndihmojnë që aktiviteti në punën e ardhëshme të jet sa më i suksesshëm dhe cilësor.

ECURIA E ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet e dyta të lira lokale u mbajtën më 26.10.2002.

Në këto zgjedhje konkuruan pesë subjekte politike dhe një kandidat i pavarur.

Elektorati kaçanikas numronte 30.337 votues.

Në zgjedhje morën pjesë 18.031 votues ose 59,44 %.

Konkuruesit në garat zgjedhore arritën këto rezultate:

Për PDK votuan 8.643 votues ose 48,54 % dhe fitoi 15 vende;

Për LDK “ 7.910 “ 44,42 % “ 14 “ ;

Për AAK “ 844 “ 4,74 % “ 2 “ ;

Për LPK “ 222 “ 1,25 % “ o “

Për PLK “ 108 “ 0,61 % “ o “ dhe

Kand.i pavarur 80 “ 0,45 % “ o “ .

Në Kuvendin e Komunës Subjektet politike, në bazë të rezultatit zgjedhor, përfaqësohen me këta kandidatë:

PDK – Partia Demokratike e Kosovës – Dega në Kaçanik

01 Xhelal Gashi
02 Heset Loku
03 Afide Kuka
04 Tahir Çaka
05 Mallzum Çajani
06 Nebahate Reka
07 Enver Jezerci
08 Lumnije Troni

09 Mirsad Shkreta
10 Rushan Ceka
11 Barije Çaka
12 Habib Guri
13 Xhabir Zharku
14 Kadrije Spahiu dhe
15 Muhamet Malsiu.

AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-Dega në Kaçanik

Ibrahim Hoxha dhe
Sabit Raka.

LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës – Dega në Kaçanik

01 Hebib Shehu	08 Ali Brati
02 Zylbehar Hasallari	09 Fiqrije Nallbani
03 Sherife Troni	10 Ahmet Kalisi
04 Musafër Luma	11 Daut Rudi
05 Lutfi Zharku	12 Sheribane Leka
06 Hyrijete Isufi	13 Ramadan Osmani dhe
07 Shiqeri Luzha	14 Milaim Berisha.

Përbërja e këtillë e Kuvendit të Komunës pëson ndryshime për arsye se një numër i antarëve të zgjedhur kanë shprehur dëshirën që ti mbajnë postet e mëparshme. Kështu në vend të :

1. Hestet Loku zgjidhet Izet Krivanjeva,
2. Afide Kuka - “ - Ganimete Malsiu dhe
3. Rushan Ceka - “ - Basri Dernjani.

Anëtarët e rinj të Kuvendit të Komunës bënë betimin solemn më
25.11.2002.

Pas një periudhe kohore në Kuvendin e Komunës bëhen ndryshime, për arsye se disa antarë të zgjedhur ofërojnë dorëheqje nga postet e antarit të Kuvendit. Kështu në vend të:

1. Muhamet Malsiu, caktohet: Bislim Krasniqi
2. Lutfi Zharku “-“ Kadrush Dogani dhe
3. Nebahate Reka “-“ Safije Kaloshi

Edhe përbërja e Kuvendit në spektrin e përbërjes politike pas një periudhe kohore , pëson ndryshime, me ate që anëtarët:

1. Milaim Berisha, nga LDK-a kalon i pavarur dhe
2. Tahir Çaka, nga PDK -a kalon i pavarur.

STRUKTURA E ANËTARVE TË KUVENDIT

TË KOMUNËS

* Kuvendi i Komunës numron 31 anëtar.

* Struktura gjinore është:

meshkuj = 22,
femra = 9.

* Moshë e antarëve të Kuvendit është prej 20 deri në 65 vjeçare.

* Sipas vendbanimit:

11 anëtar janë nga pjesa urbane e komunës, kurse
20 anëtarë nga pjesa rurale.

* Sipas kualifikimit Kuvendi i Komunës ka:

me kualifikim të mesëm shkollor = 2 anëtar,
me kualifikim të lartë shkollor = 10 anëtar,
me kualifikim superior = 17 anëtar,
puntorë me kualifikim të lartë = 1 anëtar, dhe
student = 1 anëtar.

* Kuvendi i Komunës nga anëtarët e vet 27 i ka të punësuar kurse 4 të papunësuar.

* Sipas gjendjes familjare: 24 anëtar të Kuvendit janë të martuar, ndërkaq 7 anëtar të pamartuar.

Anëtarët e Kuvendit jetojnë në bashkësi familjare me numër të antarëve të familjes së ngushtë dhe të gjërë numri i të cilëve sillet prej 3 gjer në 16 anëtar të familjes.

* Sipas gjendjes materiale anëtarët e Kuvendit kryesisht jetojnë nga të ardhurat personale që i realizojnë nga marrëdhënia e punës.

Vërejtje; Të dhënat lidhur me gjendjen familiare, materiale etj pësojnë ndryshime, ngase këto të dhëna i kemi marrë menjëherë pas konstituimit të kuvendit.

AKTIVITETI I PËRBËRJES SË RE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja e parë (I) - përruruese

Kryetari i Komunës së Kaçanikut në përbërjen e mëparshme z. Tahir Çaka ka ftuar mbledhjen e parë – përruruese të Kuvendit me anëtarët e rinj në marrëveshje me administratorin Komunal z. Zia Mohammad për datën 12.11.2002 në ora 11,00. Në këtë mbledhje me karakter përrurues do të bëhet betimi i antarëve të rinj. (Sipas nenit 48.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 është përcaktuar se: Administratori komunal i thërret mbledhjet përruruese të Kuvendit komunal, kurse sipas nenit 47.7 të Rregullores së cituar është paraparë se derisa të zgjidhet kryetari, administratori komunal i thërret dhe i udhëheq të gjitha mbledhjet e kuvendit të komunës dhe vepron si kryetar i komunës. Sipas nenit 12.1 të po të njejtës Rregullore thuhet “..... Përfaqësuesi më i vjetër i kuvendit e kryeson çdo mbledhje derisa kryetari ta bën betimin apo deklaratën solemne).

Mbledhja e Kuvendit të komunës u mbajt më 12.11.2002 duke filluar në ora 11,00.

Mbledhjen e udhëhoqi Administratori komunal Zia Mohammad.

Në mbledhje prezentuan 27 kurse munguan 4 anëtar.

Në këtë mbledhje antarët e Kuvendin bënë betimin solemn dhe nënshkruan deklaratat e interesave financiare.

Mbledhja e radhës u caktua që të mbahet më datën 25.11.2002 ku do të bëhet zgjedhja e Kryetarit dhe Zavendëskryetarit.

Administratori komunal kërkoi nga anëtarët e zgjedhur të Kuvendit të cilët mbajnë poste të cilat janë pengesë për vazhdimin e aktivitetit si anëtar i Kuvendit, deri më datën 25.11.2002 të deklarohen se cilin post dëshirojnë ta mbajnë.

Mbledhja e dytë (II) – zgjedhore

Mbledhja e dytë (me karakter zgjedhor) e Kuvendit të Komunës mbahet më datën 25.11.2002.

Në këtë mbledhje me shumicë votash në rrethin e tretë për Kryetar të Kuvendit të Komunës zgjedhet ;Xhelal Gashi antarë i PDK – Dega në Kaçanik.

Mbledhja e tretë (III)

Mbledhja e tretë e radhës mbahet më datën 03.12.2002 nën kryesinë e Kryetarit Xhelal Gashi. Edhe kjo mbledhje kishte karakter zgjedhor.

Në këtë mbledhje antarët e kuvendit në rend të punës kishin:

Zgjedhjen e Zavendës Kryetarit të Kuvendit të Komunës;
Bërja e betimit solemn të Zavendës Kryetarit;
Zgjedhja e Komiteteve komunale dhe
Qështje të ndryshme.

Në këtë mbledhje anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk arritën ta zgjedhin Zavendës Kryetarin e Kuvendit të Komunës kështuqë kjo çështje u shty për mbledhjen e ardhshme.

Prej Komiteteve komunale Kuvendi zgjedhi:

Komitetin për Politikë dhe Financa në këtë përbërje:

Xhelal Gashi, PDK, për kryesues sipas funksionit,
Habib Guri, PDK, për anëtar,
Mirsad Shkreta, PDK, “ ,
Tahir Çaka, PDK, “ ,
Mallzum Qajani PDK, “ ,
Lutfi Zharku, LDK, “ ,
Shiqeri Luzha, LDK, “ ,
Daut Rudi, LDK, “ , dhe
Hyrijete Isufi, LDK, “ .

Komitetin për Ndërmjetësim në këtë përbërje:

Izet Krivenjeva, PDK, për kryesues
Xhabir Zharku, PDK,
Nebahate Reka, PDK,
Sherife Troni, LDK,
Ahmet Kalisi, LDK dhe
Milaim Berisha, LDK.

7. Sabit Raka, AAK.

Pas një periudhe kohore përbërja e këtyre Komiteteve pësonë ndryshime, për arsye se disa antarë ofërojnë dorëheqje;Kështu në KPF-a vend të :

1.Lutfi Zharku, caktohet ; Muzafer Luma .

Edhe antari ,Muzafer Luma ,pas një periudhë ofron dorëheqje ,dhe në vend të tij ,caktohet : Hebib Shehu.

Në Komitetin për Ndermjetësim ;
Në vend të ;

- 1.Milaim Berisha, caktohet , Kadrush Dogani,
- 2.Sabit Raka, “-“ Ibrahim Hoxha dhe
- 3.Nebahate Reka, “-“ Safije Kaloshi.

Mbledhja e IV (katërt)

Mbledhja e katërt e radhës mbahet më datën 30.12.2003. Mbledhjen e kryeson dhe me te udhëheq Xhelal Gashi ,Kryetar.

Kuvendi i Komunës në këtë mbledhje për rend pune kishte:

Zgjedhjen e Zavendës Kryetarit të Komunës,
Bërja e betimit të Zavendës Kryetarit të Komunës dhe

Propozim-vendimin për ndarjen e bursave për student.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës për Zavendës Kryetari zgjedhi z.Mallzum Qajani, antar i Kuvendit të Komunës nga Hani Elezit.

Pas dorëheqjes së Zëvendëskryetarit të Komunës z. Mallzum Qajani, për shkak të zgjedhjes se tij ,Kryetar i Pilot Njësisë Komunal në Han të Elezit, në postin e Zëvendëskryetarit të Komunës zgjidhet z. Hebib Shehu.

Mbledhja e V (pestë)

Mbledhja e pestë e radhës mbahet më datën 17.01.2003. Mbledhjen e kryesoi ,Xhelal Gashi, Kryetar.

Kuvendi i Komunës në këtë mbledhje;

1. Merr Vendim për formimin e Kolegjit për intervistimin e kandidatëve për Kryeshef Ekzekutiv dhe Antarë të Bordit të Drejtorëve, në këtë përbërje,
Xhelal Gashi, për Kryesues,
Ibrahim Hoxha, për anëtar,
Muhamet Malsiu, - “ - ,
Menduh Vlashi, - “ - dhe
Izahir Doda, - “ - .

2. Aprovoj Propozimin-vendimin për dhënjën në shfrytëzim të tokës në pronësi shoqërore Bashkësisë Islame në Han të Elezit.

3. Formoj grupin punues për hartimin e një shkrese reaguese kundër arrestimit të delegatit të kuvendit të komunës, Xhabir Zharku, në këtë përbërje:

1. Mallzum Qajani,
2. Muzafer Luma dhe
3. Ibrahim Hoxha.

Mbledhja e VI (gjashtë)

Mbledhja e gjashtë e radhës mbahet më 31.01.2003 nën kryesinë e Xhelal Gashit, Kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës në rend pune kishte propozimin për emërimin e Kryeshefit Ekzekutiv dhe antarëve të Bordit të Drejtorëve.

Kjo mbledhje ndërprehet meqë antarët nga AAK dhe ata nga LDK e kanë lëshuar mbledhjen kështuqë Kuvendi i Komunës nuk ka patur kuorum për marrjen e vendimeve të plotëfuqishme.

Mbledhja e VII (shtatë)

Më 21.02.2003 ftohet mbledhja e shtatë e radhës e cila në mungesë të kuorumit shtyhet për një ditë tjetër.

Më 04.03.2003 ftohet përsëri mbledhja e shtyrë, por me reagimin e Administratorit Komunal mbledhja anulohet.

Më 14.03.2003 (mb. e jashtzakonshme) ftohet mbledhja e anuluar e cila ftohet dhe mbahet nën drejtimin e Xhelal Gashit, Kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës vendos:

1. Që për Kryeshef Ekzekutiv të Kuvendit të Komunës të emrohet z. Eshref Vishi, Jurist i diplomuar – Kryeshef Ekzekutiv i gjertanishëm,

2. Që antarëve të Bordit të gjertanishëm të Drejtorëve t’iu zgjatet mandati gjer më 31.05.2003 si dhe

3. Të shpallet Konkursi për zgjedhjen e antarëve të Bordit të Drejtorëve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja e VIII(tetë)

Më datë 17.04.2003, ftohet mbledhja e VIII-të e radhës nga Kryetari i Komunës Xhelal Gashi, mirëpo kjo mbledhje nuk është mbajtur në mungesë të kuorunit.

Më datë 23.05.2003-,ftohet mbledhja e VIII-të e radhës, nga kryesuesi Xhelal Gashi, mirëpo e njëjta nuk është mbajtur në mungesë të kuorunit.

Më datë 04.07.2003, ftohet mbledhja e VIII-të e radhës e KK, nga kryetari Xhelal Gashi, mirëpo e njëjta nuk është mbajtur në mungesë të kuorunit.

Më datë 31.07.2003, ftohet mbledhja nga një grup i delegatëve të kuvendit. Shërbimi i Kuvendit nuk ka të dhëna se kush e ka ftuar këtë mbledhje dhe për rrjedhjen e saj nuk ka qenë i informuar që të mbaj proces.

Me 11.08.2003, mbahet ,mbledhja e jashtzakonshme e KK, nën drejtimin e Xhelal Gashit-kryetar.

Në këtë mbledhje u vendos:

1.Që të shpallet konkursi për zgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv.

2.Që të shpallet konkursi për zgjedhjen e drejtorëve të drejtorive(antarëve të Bordit të Drejtorëve).

3.Formimi i kolegjit intervistues për zgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv dhe antarëve të Bordin e Drejtorëve , në përbërje prej :

1. Xhelal Gashi, kryetar.
2. Habib Guri , antarë,
- 3.Lutfi Zharku, “
- 4.Shyqeri Luzha, “ dhe
5. Ibrahim Hoxha , “

4.Aprovon bugjetin e komunës për Vitin fiskal ,2003 ,

5.Ekzekutivi i komunës të vazhdoj me punë deri me zgjedhjen e ekzekutivit të ri.

Mbledhja e IX(nëntë)

Më datë 14.10.2003, është mbajtur mbledhja e IX-të (mbl. e Rregullt)nën udhëheqjen e Xhelal Gashi,kryetar.

Në këtë mbledhje, u morën këto Vendime;

Agron Shurdhani emërohet Kryeshef i Ekzekutivit të Komunës, me profesion;inxhinier i dipl. i elektroteknikës.

Heset Loku, riemërohet drejtor i drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, me profesion ;Jurist i diplomuar.

Azem Guri, riemërohet drejtor i drejtorisë për Arsim; me profesion; Fak. i kimisë.

Agim Kuka ,emërohet drejtor i drejtorisë për Planifikim Zhvillim dhe rindërtim, me profesion ;magjistër i shkencave juridike.

Muzafer Çaka, riemërohet drejtor i drejtorisë për gjeodezi, kadastër dhe pronësi; me profesion inxhinier.

Xhelal Luma, riemërohet Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi Pylltari dhe Mbrojtje të Mjedisit, me profesion ;inxhinier i bujqësisë.

Misim Sopa ,riemërohet Drejtor i Drejtorisë për Shendetësi dhe Mirëqenje Sociale, me profesion ; Fakulteti i Sociologjisë.

U vendos të përsëritet konkursi; për Drejtor të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Punë Komunale Banesore dhe për Drejtor të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa.

Ibush Vishi, emërohet drejtor i drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, me profesion; profesor i gjuhës shqipe.

Aprovohet Strategjia e Zhvillimit ekonomik të komunës për v.2003-2006.

Aprovohet Propozim Vendimi për participimin e komunës në ndërtimin(asfaltimin) e rrugës; Fushë Pajtimi-Pompë.

Vendimi mbi Zhvillimin e diskutimit publik të Rregullorës mbi tarifrat dhe ngarkesat dhe shërbimet tjera komunale për v.2003 dhe

Vendimi mbi zhvillimin e diskutimit publik për aprovimin e Rregullorës për plotësimin e kushteve higjieno-teknike dhe të punës për liçencimin e lokaleve afariste në teritorin e komunës së Kaçanikut.

Mbledhja e X(dhjetë)

Më datë 24.11.2003 , është mbajtur mbledhja e X-të (mbl.e Rregullt) e KK, udhëhequr nga Xhelal Gashi-kryetar.

Në këtë mbledhje janë marrë këto Vendime:

U bë emërtimi i rrugës se Re të Qytetit të Kaçanikut, me emrin, Rruga:” Ismajl Raka”.

Mbledhja e XI(njëmbëdhjetë)

Më datë; 01.12.2003, është mbajtur mbledhja e XI-të (mbl.e Rregullt) e KK, udhëhequr nga Xhelal Gashi-kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës;

Aprovon Bugjetit të Komunës për vitin fiskal ,2004.

Merr Vendim për zhvillimin e diskutimit publik të vendimit për caktimin e orarit të punës për subjektet afariste që afarojnë në teritorin e komunës së Kaçanikut.

Merr Vendim për ndarjen e mjeteve bugjetore për rregullimin e varrezave të dëshmorëve(mbështjellja e varrezave më mermer).

Merr Vendim për ndarjen e 50 bursave për student të komunës ,nga 50 Euro(për 10 muaj), për vitin akademik ; 2003/2004.

Merr Vendim për formimin e Fondit për Arsim, me emrin “Mejdi Dalloshi”.

Merr Vendim për formimin e komisionit për ndarjen e bursave të studentëve për vitin akademik,2003/04.

Merr Vendim për shpalljen e Tenderit për blerjen e 4 automjeteve për nevoja të SHCK(dy urbane dhe 2 rurale).

Merr Vendim për shpalljen e Tenderit për blerjen e teknologjisë informative dhe të punës për nevoja të SHCK.

Merr Vendim për Lejimin e mjeteve bugetore për participimin e komunës në 5 projekte, të financuara nga Banka Botërore.

Merr Vendim për participimin e komunës në Projektin e Ujësjetës në Han të Elezit dhe Merr Vendim për kthimin e tokave ish pronarëve(318,55 ha)në vendin e quajtur Çardak.

Mbledhja e XII(dymbëdhjetë)

Më datë: 23.12.2003, mbahet mbledhja e XII-të (mbl.e Rregullt) e KK, kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

- 1.Merr Vendim për Aprovimin e Planit të Gadishmërisë Civile dhe Mbrojtjes Emergjente bashkë me Vlerësimin e rrezikut në Komunën e Kaçanikut.
- 2.Merr Vendim për Zhvillimin e diskutimit publik të Rregullorës për Mbrojtjen e Ambientit në teritorin e Komunës së Kaçanikut.
- 3.Mer Vendim për caktimin e Lokacionit të Përkohshëm për ,mbajtjen e Tregut të Gjelibërt në Kaçanik, në zonën kadastrale në Bob nr.226/1, fleta poseduese 201.
- 4.Mer Vendim për përseritjen e konkursit për postet :
 1. Drejtor të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa dhe
 2. Drejtor të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Punë Komunale Banesore.
- 5.Formon grupin punues për përpilimin e deklaratës në të cilën reagohehet ndaj arrëstit të 5 luftetarëve të UÇK-së, në këtë përbërje:
 1. Muzafer Luma,
 2. Mallzum Qajani dhe
 3. Ibrahim Hoxha.

Viti 2004

Mbledhja e I (Parë)

Më datë:16.02.2004, është mbajtur mbledhja e I-rë e KK(mbl. e Rregullt)udhëhequr nga Kryetari i Komunës , Xhelal Gashi.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës ;

1. Merr Vendim që Propozim Rregullorja për tarifatat dhe ngarkesat administrative dhe shërbimeve tjera komunale të i kthehet edhe një herë propozuesit për rishqyrtim.

2.Merr Vendim për Aprovimin e Rregullorës për Plotësimin e kushteve higjiëno-teknike dhe të punës për liçencimin e subjekteve afariste që afarojnë në teritorin e komunës së Kaçanikut.

3.Merr Vendim që Propozim Vendimi për caktimin e orarit të punës së subjekteve afariste që veprojnë në teritorin e komunës së Kaçanikut, të i kthehet propozuesit në rishqyrtim.

4.Merr Vendim për Aprovimin e Rregullorës për aplikimin e tatimit në Pronë për v.2004.

5.Merr Vendim për Aprovimin e Vendimit për lejimin e mjeteve financiare për projektin:”Rregullimin e trotuarit në rrugën “Ismajl Raka” në Kaçanik”.

6. Merr Vendim për riemërimin e Qamil Stagovës, për Drejtor të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Punë Komunale Banesore.

7. Merr Vendim për riemërimin e Fikri Verbanit, për Drejtor të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa.

Mbledhja e II (dytë)

Më datë: 15.03.2004, është mbajtur mbledhja e II-të (mbl. e Rregullt) e KK,udhëhequr nga nenkryetari i komunës ,Mallzum Qajani.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

1.Merr Vendim për caktimin e orarit të punës së subjekteve afariste që afarojnë në teritorin e komunës së Kaçanikut.

2.Merr Vendim për Aprovimin e Rregullorës për pagesën e tarifave dhe ngarkesave dhe shërbime tjera komunale për v.2004.

3.Merr Vendim për Aprovimin e Rregullorës për mbrojtjen e Ambientit në teritorin e komunës së Kaçanikut.

4.Merr Vendim për ndryshim-plotësimin e Vendimit për ndarjen e bursave të studentëve(shtohet numri i bursistëve edhe për një student) .

5.Merr Vendim për Aprovimin e Variantës së tretë e propozuar nga drejtoria për planifikim zhvillim dhe rindërtim, për Ndërtimin e Ujësjellësit në fsh. Stagovë, (uji mirret në Lokacionin e fsh. Koxhaj, me anë të shpimit-Hapja e Pusit).

Mbledhja e III (tretë)

Mbledhja e III-të (mbl. e Rregullt) e Kuvendit të Komunës është mbajtur me 08.04.2004, është kryesuar nga :Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

- 1.Merr Vendim për Aprovimin e Raportit të Punës së Shërbimit Civil të Kuvendit të Komunës për v.2003.
- 2.Merr Vendim për Refuzimin e Propozim Vendimin e DUPKB, për ndërtimin e objektit të Gjykatës në lokacionin ku janë të vendosura themelet e Gjykatës, në bazë të Vendimit 08Nr. 350-46 të dt. 20 prill 1990.

Mbledhja e IV(katërt)

Më datë ; 22.04.2004, është mbajtur mbledhja e IV-të (mbl. e Rregullt) e KK, udhëhequr nga :Xhelal Gashi,kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës;

- 1.Debatoj për Projektligjin mbi Vetqeverisjen Lokale,
- 2.Merr Vendim për Aprovimin e Programeve të Punës për v.2004 të nëntë(9)drejtorive komunale.
- 3.Debatoj lidhur me Informatën për ngjarjet e marsit të vitit 2004.

Mbledhja e V(pestë)

Më datë :01.06.2004, është mbajtur mbledhja e V-të (mbl. e Rregullt) e KK, bashkëkryesuar nga kryetari dhe nenkryetari i KK Kaçanik, Xhelal Gashi e Mallzum Qajani.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës;

1. Merr Vendim për Aprovimin e Raportit mbi realizimin e mjeteve bugetore për vitin fiskal , 2003; (Administratës, Arsimit, Shendetësisë dhe Shërbimit të Zjarrëfiksave)
2. Merr Vendim për lëshim në diskutim publik të Rregullorës mbi transportin rrugor në teritorin e komunës së Kaçanikut.
3. Merr Vendim për Aprovimin e Rregullorën mbi kompenzimet e antarëve të kuvendit, komiteteve, komisioneve të stafit të SHCK dhe ndalesat financiare.
- 4.Merr Vendim për kompenzimet e Stafit politik.
5. Merr Vendim për formimin e Komitetit të Komuniteteve ;në përbërje prej 5 antarësh: Basri Dernjani,(antarë i KK nga subjekti i PDK-së), kryesues

Muzafer Luma (antarë i KK nga subjekti i LDK-së).
Një përfaqësues nga fsh. Ivajë (Sabit Rexha)
Një përfaqësues nga fsh. Guranë (Shefqet Lusnjani)
Një përfaqësues nga fsh. Bajnicë (Gafurr Salihu).

Antarët nga pika 3,4 dhe 5 janë propozuar nga fshatrat përkatëse.

Në ndërkohë edhe në këtë komitet bëhen ndryshime, sepse anëtari; Muzafer Luma jep dorëheqje nga ky komitet dhe në vend të tij caktohet: Ramadan Osmani .

Mbledhja e VI (gjashtë)

Më datë: 22.07.2004, është mbajtur mbledhja e VI-të (mbl. e Rregullt) e KK, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryetar.
Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës;

1. Merr Vendim për Rishikimin Gjashtmuorë të Bugjetit të Komunës për vitin fiskal 2004.
2. Merr Vendim për Lejimin e mjeteve bugjetore për asfaltimin e (800m rrugë) të Rrugës :Ura e Tregut- Shkolla e mesme Profesionale.
3. Merr Vendim për Lejimin e mjeteve bugjetore për asfaltimin e rrugës: “Emin Duraku”-Lagja e Re në Kaçanik.

Mbledhja e VII (shtatë)

Më datë: 24.09.2004 është mbajtur mbledhja e VII-të (mbl. e Rregullt) e KK, kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar .

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës;

1. Merr Vendim për Aprovimin e Raportit për Realizimin e mjeteve bugjetore, periudha janar-gusht 2004.
2. Merr Vendim për ndarjen e bursave studentëve të caktuar të komunës për vitin akademik : 2004/2005 (55 bursa nga 50 Euro për 10 muaj).
3. Merr Vendim për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për student të caktuar të komunës, për vitin akademik: 2004/2005, në këtë përbërje:

1. Një antarë nga Drejtoria e Arsimit.
2. Basri Dernjani , antarë i KK nga subjekti i PDK-së.
3. Nebahate Reka, ‘ ‘ ‘ ‘ ‘ ‘ ‘ ‘ ‘ ‘
4. Ibrahim Hoxha, antarë i KK nga subjekti i AAK dhe
5. Një antarë i KK, nga subjekti i LDK-së.

Mbledhja e jashtzakonshme

Mbledhja e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës u caktua për datë 11.08.2004, nga Xhelal Gashi, kryetar.

Për këtë takim ishte propozuar ky Rend Pune:

Rishqyrtimi i Vendimit të KK, 01Nr.121/04 i datës 08.04.2004(që ka të bëjë me caktimin e Lokacionit për ndërtimin e objektit të Gjykatës).

Kjo mbledhje nuk është mbajtur në Mungesë të Kuorumit.

Mbledhja e VIII (tetë)

Më datë: 18.11.2004, është mbajtur mbledhja e VIII-të (mbl.e Rregullt) e KK, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryetar .

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës;

1. Merr Vendim për Anulimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 121/04, më të cilën është refuzuar propozim vendimi i DUPKB për ndërtimin e objektit të Gjykatës në lokacionin ku janë të vendosura themelet e Gjykatës me Vendimin 08Nr. 350-46 të dates 20 prill 1990, ndërsa propozim vendimi i DUPKB ,VËRTETOHET, dhe Gjykatës Komunale në Kaçanik i Caktohet Lokacioni për ndërtimin e objektit të Gjykatës në lokacionin ku janë të vendosura temelet e Gjykatës me vendimin e Kuvendit të Komunës 08Nr. 350-46 të datës 20 prill 1990.

2. Merr Vendim për Aprovimin e Raportit të Drejtorisë së Arsimit mbi suksesin e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të komunës për vitin shkollor 2003/2004.

Mbledhja e IX (nëntë)

Më datë:14.12.2004,është mbajtur mbledhja e IX-të (mbl. e Rregullt) e KK,kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar,

Në këtë mbledhje KK;

1.Merr Vendim për Aprovimin e Bugjetit të Komunës për v.2005-2007 dhe kufijt Final Bugjetor për vitin fiskal 2005.

2. Merr Vendim që Agjenda zhvillimore e komunës për v.2004-2007, të i kthehet grupit punues për rishqyrtim.

Kuvendi i Komunës gjat v.2004, ka mbajtur një mbledhje me karakter Solemn. edhe ate: Me datë 11.06.2004, Kuvendi i Komunës ia kushton një mbledhje solemne ;11 Qershorit-Ditës së Çlirimit të Komunës .Mbledhja është kryesuar nga Xhelal Gashi ,kryetar. Në këtë mbledhje mori pjesë edhe kryetari i Rrethit të Qarkut të Beratit -Shqipëri, z. Pelivan Shatri.

Gjat v.2004, Kuvendi i Komunës ka mbajtur 2 Tubime Publike me Popullatën e kësaj komune.

1. Njëri takim publik është mbajtur në Han të Elezit, ndërsa
2. Takimi tjetër është mbajtur me 17.12.2004 në Kaçanik.

Viti 2005,

Mbledhja e I-rë e KK është caktuar për datë; 07.02.2005.

Kjo mbledhje është shtyrë për datë 11.02.2005, për arsye se nuk ka patur kushte pune për të u mbajtur kjo mbledhje(shkaqe teknike).

Mbledhja e I (parë)

Mbledhja e I-rë(mbl. e Rregullt) e KK është mbajtur me datë 11.02.2005,në sallën e mbledhjeve të shtepisë së shëndetin në Kaçanik, është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje morën pjesë edhe një delegacion nga komuna partneritete (komuna si motra), e Musseldorfit të Zvicrës.

Në këtë takim Kuvendi i Komunës;

1. Merr Vendim për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa, periudha janar-dhjetor 2004),

2. Merr Vendim për Aprovimin e Rregullorës për vendosjen e tatimit në pronë në teritorin e komunës së Kaçanikut për v.2005.

3. Merr Vendim për dryshim –plotësimin e Vendimit mbi emërimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, ashtuqë në vend të anëtarit :

1. Lutfi Zharku ,caktohet :Muzafer Luma.

- 4.Draft- Strategjia Komunale për kthim të qëndrueshem(në shqyrtim të kësaj pike mbledhja e KK është ndërprerë, sepse delegatet nga PDK-a me përjashtim të kryetarit e lëshuan mbledhjen,me arsyetim se materiali për këtë pikë u është shpërndarë në mbledhje, kështuqë nuk pati ,kuorum që të shqyrtohet kjo pikë në këtë takim).

Mbledhja e II(dytë)

Mbledhja e dytë e Kuvendit të Komunës(mbl. e Rregullt) është mbajtur me datë 28.03.2005, është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje, KK;

1. Merr Vendim për Aprovimin e Raportit mbi realizimin e mjeteve bugjetore për periudhen janar-dhjetor 2004(i përmbledhur për të gjitha njësitë shpenzuese bugjetore);
a) Raporti mbi realizimin e mjeteve bugjetore të Administratës Komunale,

- b)Raporti mbi realizimin e mjeteve bugjetore të Arsimit.
- c) Raporti mbi realizimin e mjeteve bugjetore të shendetësisë,
- d) Raporti mbi realizimin e mjeteve bugjetore të shërbimit të zjarrëfiksive.

2. Merr Vendim për Refuzimin e Projekt-Strategjisë Komunale për kthim të qëndrueshëm.

Mbledhja e III (tretë)

Mbledhja e tretë (mbl. e Rregullt) e Kuvendit të Komunës është mbajtur me datë 21.04.2005, është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje KK:

1. Merr Vendim për Aprovimin e Raportit të Punës se Bordit të Drejtorëve për v.2004.
2. Merr Vendim për Aprovimin e Raportit të Punës se Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme për v.2004.
- 3.Merr Vendim për Aprovimin e Raportit të Punës se Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa për v.2004,
4. Merr Vendim për Aprovimin e Raportit të Punës së Drejtorisë për Planifikim Zhvillim dhe Rindërtim për v.2004,
5. Merr Vendim për Aprovimin e Raportit të Punës së Drejtorisë për Arsim për v.2004,
6. Merr Vendim për Aprovimin e Raportit të Punës së Drejtorisë për Urbanizëm dhe Punë Komunale Banesore për v.2004.
- 7.Merr Vendim për Aprovimin e Raportit të Punës së Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi për v.2004,
8. Merr Vendim për Aprovimin e Raportit të Punës së Drejtorisë për Shendetësi dhe Mirëqenje Sociale për v.2004,
- 9.Merr Vendim për Aprovimin e Raportit të Punës së Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport për v.2004,
- 10.Merr Vendim për Aprovimin e Raportit të Punës se Drejtorisë për Bujësi, Pylltari dhe Mbrojtje të Mjedisit për v.2004 dhe
11. Merr Vendim për Aprovimin e Raportit të Punës së Zyrës për Siguri Civile dhe Gadishmëri Emergjente për v.2004.

Mbledhja e IV(katërt)

Mbledhja e IV-të (mbl. e Rregullt) e Kuvendit të Komunës, është mbajtur me datë 03.05.2005, është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje KK;

1. Merr Vendim për Aprovimin e Programeve të Punës se 9(nëntë) drejtorive komunale për v.2005,
- 2.Merr Vendim për Aprovimin e Projekt- Statutit të QKMF(Qendrës Kryesore të Mjeksisë Familjare) të Kaçanikut.
3. Merr Vendim për ndryshim-plotësimin e Vendimi për emërimin e Komitetit për Ndermjetësim, ashtuqë , në vend të:

1.Milaim Berisha, caktohet: Kadrush Dogani

2.Sabit Raka , -"- : Ibrahim Hoxha.

Mbledhja e V(pestë)

Mbledhja e V-të e (mbl. e Rregullt) është mbajtur me datë 17.05.2005, është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar,
Në këtë mbledhje KK;

1. Merr Vendim për ndryshim- plotësimin i Vendimit për caktimin e orarit të punës së subjekteve afariste që funksionojnë në teritorin e komunës së Kaçanikut.
2. Merr Vendim për caktimin e tarifave dhe ngarkesave administrative dhe shërbimeve tjera komunale.
3. Merr Vendim për Aprovimin e Rregullorës për organizimin e transportit rrugor në teritorin e komunës së Kaçanikut.

Mbledhja e VI(gjashtë)

Mbledhja e VI-të (mbl.e Rregullt) është mbajtur me datë, 21.06.2005, është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje KK;

1. Merr Vendim për Emërimin e Këshillit Mbikqyrës në QKMF, në këtë përbërje;

- 1.Muharrem Leka, kryetar,
- 2.Nejaz Luma, anëtar,
- 3.Ismajl Bektoshi, “
- 4.Menduh Kaloshi “ dhe
- 5.Nazif Reka, “

2.Merr Vendim për Lejimin e mbajtes se Tregut të Gjellbërt edhe për një kohë të caktuar në Lokacionin ekzistues-(deri në fund të v.2009) në ngastrën kadastrale 201 të Zonës Kadastrale të Bobit, pronë e Hamide Nuhi Demes.

3. Merr Vendim për emërimin e pjesës së lagjes Dushkaja me emrin : Rruga” Remzi Zharku”.

4. Debatoj Informatën e Drejtorisë së Arsimit lidhur me numrin e puntorëve arsimor në vitin shkollor 2004/2005.

Mbledhja e VII(mbledhje e jashtzakonshme)

Mbledhja e VII-të e radhës është mbajtur me datë: 01.07.2005, është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje, KK;

1. Merr Vendim për Aprovimin e Projektit të Strategjisë Komunale për kthim të Çëndrueshëm.

Mbledhja e VIII(tetë)

Mbledhja e VIII-të (mbl. e Rregullt) është mbajtur me datë 13.09.2005, nën udhëheqjen e Xhelal Gashit, kryetar.

Në këtë mbledhje u morën këto Vendime;

1. U Vendos të bëhet rishikimi gjashtmuor i bugjetit të Komunës për vitin fiskal ,2005. Mbledhja e IX(nëntë)

Mbledhja e IX-të (mbl. e Rregullt)e Kuvendit të Komunës është mbajtur me datë 22.11.2005 , është kryesuar nga Xhelal Gashi , kryetar.

Në këtë mbledhje u morën këto Vendime;

1. U miratua raporti për realizimin e mjeteve bugjetore, periudha ;01.01.2005 – 30.09.2005, me kërkesë që në mbledhjen vijuese të specifikohen shpenzimet bugjetore të çdo shërbimi.

2. U nxorren pesë Konkluzione lidhur me gjendjen e pyjeve në teritorin e komunës së Kaçanikut.

3. U muar Vendimi për Aprovimin e Dorëheqjes se Mallzum Qajanit , nga posti i Nenkryetarit të Kuvendit të Komunës Kaçanik, për shkak të zgjedhjes se tijë ,kryetar i Kuvendit në Pilot Njësinë komunale në Han të Elezit.

Mbledhja e X(dhjetë)

Është mbajtur me datë 27.12.2005. Mbledhja është mbajtur në objektin e shtëpisë së shëndetit të QKMF në Kaçanik , është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje KK,

1. Merr Vendim për formimin e Komisioni për zbatimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e Nenkryetarit të Kuvendit të Komunës, me këtë përbërje;

1. Habib Guri,
2. Daut Rudi dhe
3. Sabit Raka.

Për Nenkryetarë të KK ,ishin propozuar,kandidatët;

1. Bahrie Çaka, antare e KK nga subjekti i PDK-së dhe
2. Hebib Shehu, antar i KK nga subjekti i LDK-së.

2. Hebib Shehu ,antarë i LDK-së dega në Kaçanik, zgjidhet: Nenkryetar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut(në rrethin e tretë të votimit , me shumicë votash,më16 votë “PRO”),

Kuvendi i Komunës Kaçanik gjat vitit 2005,nën udhëheqjen e Xhelal Gashit, kryetar, ka mbajtur dy Mbledhje Solemne,dhe ate;

1.Më datë 02.06.2005, ,është mbajtur mbledhje Solemne e Kuvendit të Komunës me rastin e vizitës se Leutnant General Iv de Kermabov- Komandant i forcave të KFOR-it në Kosovë, që i bëri komunës se Kaçanikut.Temë debati i këtij takimi ishte: “Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut” dhe

2.Më datë 11.06.2005, Kuvendi i Komunës ka mbajtur një mbledhje Solemne për nderë të” Ditës se Çlirimit të Komunës së Kaçanikut-11 Qershorit”.

Gjat vitit 2005, janë organizuar dha mbajtur edhe debate publike me qytetarë, të udhëhequra nga kryetari i KK , z. Xhelal Gashi,

1. Me datë 17.04.2005 ,është mbajtur debati me temën” Standardet për Kosovën” Në këtë debat ka marrë pjesë koordinatori për Standarde për Kosovën, z. Avni Arifi.Debati është mbajtur objektin e shtëpisë së kulturës “Xheladin Kurtaj” në Kaçanik,në sallën e madhe.

2. Me datë 12.12.2005, është mbajtur debati me temën” Standardet, Statusi, Europa”. Në këtë debat ka marrë pjesë:

1. Kryeadministratori i Kosovës; Soren Jessen Petersen,
 - 2.Shefi i zyrës se Havier Solanës: Torbjorn Sohlstrom ;
 - 3.Përfaqesuesi i Këshillit të Europës; Zurab Katchkatchishivilli dhe
 - 4.Antari i grupit negociator dhe kryetar i partisë demokratike të Kosovës ; Hashim Thaqi.
- Debati është mbajtur në sallën e vogël të shtëpisë së kulturës “Xheladin Kurtaj në Kaçanik.

Ngjarje tjera, të vitit 2005;

Me datë :01.06.2005, është formuar Asambleja Rinore e Kaçanikut.

Mbledhja është kryesuar nga :Fatmir Çaka-koordinator i Sektorit për Rini pranë DKRS.

Në këtë mbledhje për Kryetar të Asamblesë Rinore të Kaçanikut ,është zgjedhur,Fatlume Shehu.

Pas dorëheqjes se kryetarit të Asamblesë Rinore, Fatlume Shehu,mësohet se në postin e kryetarit të Asamblesë së Fëmijëve është zgjedhur, Besarta Idrizi.

Me datë 06.07.2005, nën kryesinë e z. Mallzum Qajani, është mbajtur një mbledhje me Këshilltarët e Kuvendit të Komunës Kaçanik që janë nga Hani i Elezit dhe grupin punues për Decentralizim.Mbledhja u mbajt në Zyrën e Kryetarit të Komunës.

Nga grupi punues i Decentralizimit, në mbledhje ishin zyrtarët: Sazan Ibrahim, Erik Broven dhe Pier Hairson.

Temë debati ka qenë: Pilot Projekti për Decentralizimin e komunave, me theks të veçant” Pilot Njësia Komunale e Hanit të Elezit”.

Viti 2006

Mbledhja e I(parë)

Mbledhja e I e Rregullt e Kuvendit të Komunës është mbajtur me datë: 27.02.2006, Mbledhja është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje u morën këto Vendime;

1.Aprovohet Propozim Vendimi për zbatimin e Rregullorës së tatimit në pronë të vitit 2005 edhe në vitin 2006.

2.Miratohet Tabela Finale e Bugjetit për vitin 2006-Shpërndarja e Bugjetit nga Komuna për vitin 2006 se bashku me Listën me Prioritet të Projekteve Kapitale .

Mbledhja e II(dytë)

Me datë 28.03.2006, Kuvendi i Komunës mbajti mbledhjen e II-të (mbl. e Rregullt) për vitin 2006. Mbledhja u kryesua nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje KK, vendosi;

1. Që të Miratoj Raporti për realizimin e mjeteve bugetore për vitin fiskal: 2005 me katër programet shpenzuese bugetore, dhe ato në ; Administratë Komunale, Arsim, Shendetësi dhe Shërbimin e Zjarrëfikjes.

2. U muar Vendim për Aprovimin e Programeve të Punës së Drejtorive Komunale për vitin 2006, dhe ato;

1. Programi i Punës së Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme,
2. Programi i Punës së Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa,
3. Programi i Punës së Drejtorisë për Planifikim Zhvillim dhe Rindërtim,
4. Programi i Punës së Drejtorisë për Arsim,
5. Programi i Punës së Drejtorisë për Urbanizëm dhe Punë Komunale Banesore,
6. Programi i Punës së Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi ,
7. Programi i Punës së Drejtorisë për Shendetësi dhe Mirëqenje Sociale,
8. Programi i Punës së Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.
9. Programi i Punës së Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Mbledhja e III(tretë)

Mbledhja e III-të e KK(mbl. e Rregullt) është mbajtur me datë 28.04.2006, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje, u miratuan;

1. Raporti i punës së Bordit të Drejtorëve, për vitin 2005
2. Raporti i punës së Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme , për vitin 2005.
3. Raporti i Punës së Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa për vitin 2005,
4. Raporti i Punës së Drejtorisë për Planifikim Zhvillim dhe Rindërtim për vitin 2005
5. Raporti i Punës së Drejtorisë për Arsim për vitin 2005,
6. Raporti i Punës së Drejtorisë për Urbanizëm dhe Punë Komunale banesore për vitin 2005,
7. Raporti i Punës së Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi për vitin 2005,
8. Raporti i punës së Drejtorisë për Shendetësi dhe Mirëqenje Sociale për vitin 2005,
9. Raporti i Punës së Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport , për vitin 2005,
10. Raporti i Punës së Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Mbrojtje të Mjedisit, për vitin 2005,
11. Raporti i Punës së Zyrës për Siguri Civile dhe Gadishmëri Emergjente, për vitin 2005 dhe
12. Raporti i Zyrës së Prokurimit, për vitin 2005.

Përmbledhja e punës së të gjitha këtyre shërbimeve komunale ,është puna një vjeqare e SHCK, andaj si konkludim i kësaj del se KK , në këtë mbledhje Miratoj;

13. Raportin e Punës së Shërbimit Civil të Kuvendit të Komunës, për vitin 2005.

Mbledhja e IV (katërt)

Mbledhja e IV-të (mbl. e Rregullt) e KK është mbajtur me datë; 29.05.2006, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje u ;

1.Miratua Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2005.

2.U muar vendim për formimin e Këshillit të Ekspertëve të planifikimit , në përbërje prej 7 antarësh, dhe ate:2 ekonomist, , 2 inxhinier 1 jurist 1 nga 1 agronom, dhe sektori i arsimit.

Sa i përket emrave, KK ia delegon të drejtën KPF-a të bëjë përcaktimin e emrave të antarëve profesionist të lëmive përkatëse që mendon se do të kontribojnë në këtë drejtim.

3.U muar vendim për Riformimin e rrugës në lagjen Dushkaja.

4.U debatua për rrjedhjet e privatizimit në Komunën e Kaçanikut,

Lidhur me këtë çështje KK formoj komisionit në përbërje, prej tre antarësh;

1.Kryetari i KK, (Xhelal Gashi),

2.Nenkryetari i KK (Hebib Shehu)dhe

3.Kryeshefi ekzekutiv i KK (Agron Shurdhani)

Për hartimin e një shkrese Reaguese në emër të KK me të cilën reagohet për privatizimin e disa pronave të palujtshme të komunës së Kaçanikut të shpallura në Rundin e 16 të privatizimit nga AKM-a ,sepse të njëjtat janë kontestuese dhe për to zhvillohet procedurë gjyqësore në gjykatat kompetente.

Mbledhja e V (pestë)

Mbledhja e V-të (mbl. e Rregullt) e KK është mbajtur me datë: 31.07.2006, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje ;

1. Kuvendi i Komunës, u njoftua me Statutin e QKMF-në Kaçanik,i miratuar nga Ministria e Shendetësisë.

2.U vendosë që DSHMS, të ndërmerr veprime të nevojshme për zbatimin e këtij Statuti.

3.U muar Vendim për Lejimin e mjeteve bugjetore për financimin e QEAP”Agimi” në Kaçanik pas rishkimit gjashtë mujor për periudhen: korrik-dhjetor të vitit 2006, për kompenzimin e pagave për 8 puntorë të kësaj qendre.

Mbledhja e VI(shtatë)

Mbledhja e VI-të (mbl. e Rregullt) e KK është mbajtur me datë 19.09.2006 është udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje u vendos;

1.Që TMK-së Zonës së 6 të Mbrojtjes , Brigades “ Agim Bajrami në Kaçanik”, të i lejohet shfrytëzimi i Lokacionit në vendin e quajtur “Meraja e Koxhes”

Sipërfaqja e cila iu dha në shfrytëzim kësaj Brigade është 01.50,00 ha, në pjesën veriore të parcelës 156, dhe i ipet në shfrytëzim për ndërtimin e KAZERMËS.

Mbledhja e VII(shtatë)

Me date;27.09.2006 ,është mbajtur mbledhja e VII-të (mbl. e Rregullt) e KK, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje u KK, mori këto Vendime;

1. Vendimi për miratimin e Planit Bugjetor për vitet 2007-2009,-Përmbledhja e Bugjetit të Organizatës Bugjetore të Komunës për vitin 2007.
- 2.Vendimi për miratimin e propozimit të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, për Përritjen e Regjistrave të Gjendjes Civile.
- 3.U njoftua KK me një Informatë të pregaditur nga kryetari i komunës lidhur me bisedimet e zhvilluara të organeve kompetente komunale me AKM-në për pronat e palujtshme(objektet) të cilat AKM-a do të i privatizoj,
- 4.U informua KK për çeshtjen e kompenzimit të delegateve të KK së Kaçanikut që janë nga Hani i Elezit , e që kryejnë funksion të dyfisht.
- 5.U informa KK për projektet kapitale që janë realizuar në vitin 2006 dhe ato që janë në procedurë të realizimit.

Mbledhja e VIII(Tetë)

Mbledhja e VIII-të (mbl. e Rregullt) e Kuvendit të Komunës, është mbajtur me datë: 27.10.2006, është udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje u muar;

1. Vendim, për vazhdimin e kontratave të punës se Ekzekutivit të Komunës(të gjithë anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv) edhe për një vit, respektivisht deri me 27.10.2007.
- 2.U vendosë të miratohet Raporti i Drejtorisë së Arsimit, për suksesin e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme për vitin shkollor 2005/2006.

Mbledhja e IX(nëntë)

Me datë 22.11.2006, u mbajtë mbledhja e IX-të (mbl. e Rregullt) e Kuvendit të Komunës, është udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje u muar;

- 1.Vendim për Miratimin e Planit të Evakuimit të personelit nga objekti i kuvendit komunal në rast rreziku.
- 2.U konkludua që Propozim Aktvendimet e DGJKP(6 propozim –aktvendime) për bartjen e të drejtës se shfrytëzimit të shtyhen për shqyrtim për një mbledhje tjetër të Kuvendit të Komunës.

Gjat vitit 2006, Kuvendi i Komunës ka mbajtur dy mbledhje komemorative, dhe ate;

Mbledhja e I-rë(parë) Komemorative ,është mbajtur më datë 23.01.2006, në shenjë përkujtimi për jetën dhe veprën e Presidentit të Kosovës , Dr. Ibrahim Rugova.Mbledhja është mbajtur në konferencrum(sallën e mbledhjeve),udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryetar.

Mbledhja e II-të(dytë) Komemorative është mbajtur më datë 13.12.2006, në shenjë përkujtimi të jetës dhe veprës së veprimtarit të çeshtjes kombëtare , Sali Bajra.Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit,është udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryetar.

Kuvendi i Komunës gjat vitit 2006,nën udhëheqjen e Xhelal Gashit ,kryetar, ka mbajtur një mbledhje me karakter solemn, organizon debate publike me qytetarë të komunës, dhe ate;

Me datë 03.04.2006, Kuvendi i Komunës ka mbajtur mbledhje Solemne me rastin e vizitës se Presidentit të Kosovës Dr. Fatmir Sejdiu,që i bëri komunës së Kaçanikut Pas mbledhjes, presidenti ka mbajtur një takim më gazetarë,pastaj i shoqëruar me strukturat udhëheqëse komunale,presidenti iu bëri vizitë varrezave të dëshmorëve.I shoqëruar me presidentin ishte edhe zëvendësministri i pushtetit lokal , Aziz Lila.

Më datë 05.12.2006, Kuvendi i Komunës ka organizuar debat publik me qytetarët e komunës se Kaçanikut. Nga qytetarët e komunës se Kaçanikut nuk ka patur të interesuar të marrin pjesë në këtë debat, andaj ky debat është ç’vendosur për datë 22.12.2006.

Me qëllim që të gjinden forma tjera të mbajtjes se debatit publik, KK në bashkëpunim me Radio Kaçaniku, me datë 22.12.2006, ka organizuar debat publik me qytetarët e komunës.Pyetjet janë bërë permes interenetit, telefonatave etj.Ky debat publik i organizuar në këtë formë, është mbajtur në zyrën e kryetarit.

Komuna e Kaçanikut ka Mardhënjë Partneriteti me Komunën e Musseldorfit të Zvicrës që nga viti 2001.Edhe në vitin 2006, nga data: 31 mars një delegacion nga komuna e Musseldorfit , në krye me Petter Bill-kryetar komune , i bëri një vizitë një javore Komunës së Kaçanikut, me ç’rast me 5 prill 2006, ky delegacion i shoqëruar me strukturat udhëheqëse komunale,vendosi dy “Pllaka” ne shenjë partneriteti të komunave si motra; Musseldorfit dhe Kaçanikut.Pllakat u vëndosën në skaj të magjistralës, njëra në hyrje të qytetit ,magjistranja për Prishtinë, tjetra në dalje të qytetit ,magjistranja për në Han të Elezit.Po në këtë ditë ky delegacion pranë objektit të shtëpisë së kulturës “Xheladin Kurtaj” në Kaçanik, vëndosi një “Grill” I shoqëruar në këtë ditë më këtë delegacion ishte edhe :shefja e Zyrës Gjermane në Prishtinë: Ky delegacion mori pjesë edhe në mbledhjen Solemne të KK,të datës 03.04.2006, të organizuar me rastin e vizitës së Presidentit të Kosovës Dr. Fatmir Sejdiu,që i bëri komunës së Kaçanikut.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës janë monitoruar nga UNMIK-u dhe OSBE-a. Nga Administrata e UNMIK-ut, në kohën e konstituimit të këtij kuvendi, Administrator i komunës së Kaçanikut ishte: Zia Mohammad ndërsa zyrtar : Emanuel Ubajlioro.Pas

shkuarjen se administratorit,Zia, një kohë z. Ubajlioro ushtroi detyrën e përgjegjës në administratën e UNMIK-ut., më vonë përgjegjës vjen: Jan Piotr Jaremczuk, pastaj Jerosllav Kozak,tani është Punya Paudel.

Ndërsa nga OSBE-a, në kohën e konstituimit të këtij kuvendi, shef i zyrës rajonale ishte,Horst Denecke, pastaj Francis Carlier, më vonë vjen, Josef Flood-drejtor.

Vërejtje;Bazë për nxjerrjen e këtij Buletini kanë shërbyer procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit.

SHËRBIMI I KUVENDIT